

VENDIM
Nr. 519, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka si mision hartimin e zbatimin e politikave në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufrutore.

3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) harton e zbaton politikat shtetërore për çështjet e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufrutore;

b) harton e propozon miratimin e projekteve për përafrimin e legjislacionit në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, veterinarisë, peshkimit dhe akuakulturës me normat e kërkesat e Bashkimit Evropian, miraton projektaktet që janë pjesë e fushës së përgjegjësisë, si dhe vlerëson nevojat e planifikon fondet e nevojshme për zbatimin e tyre;

c) harton e zbaton politikat orientuese, mbështetëse dhe nxitëse për prodhimin bujqësor e blegtoral, si dhe kujdeset për zhvillimin e koordinuar të bujqësisë;

ç) ndjek përgatitjen e strukturave të saj për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të Komisionit Evropian për zhvillimin rural, harton e zbaton programin IPARD, në përputhje me aktet rregullatore të Bashkimit Evropian;

d) zbaton mbështetjen financiare të qeverisë për fermerët, agrobizneset dhe peshkatarët, bazuar në politikat e programit të qeverisë për mbështetjen e tyre;

dh) harton e zbaton politika për miradministrimin e tokës bujqësore, si dhe mbrojtjen e tokës nga proceset natyrore dhe faktorët e tjerë që mund ta dëmtojnë atë;

e) harton e zbaton politika për menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes dhe të kullimit, si dhe merr masa të përshtatshme për mbrojtjen e tokave nga përmbytjet;

ë) harton e zbaton politikat për ushqimin, sigurinë ushqimore, cilësinë e produkteve ushqimore, duke përfshirë gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë;

f) harton e zbaton politikat në fushën e veterinarisë, për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, epidemiologjinë, identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe lëvizjeve të tyre, me qëllim garantimin e shëndetit publik veterinar;

g) harton e zbaton politikat në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe luftimit të dëmtuesve;

gj) bashkëpunon me organet e vetëqeverisjes vendore për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe të kullotave;

h) harton e zbaton politikat shtetërore për peshkimin dhe akuakulturën në Shqipëri dhe menaxhimin e burimeve peshkore;

i) harton e zbaton politikat e zhvillimit rural, agroturizmit, për standardet e cilësisë, produktet organike, si dhe cilësinë e jetës në fshat dhe zhvillimin rural;

j) kujdeset për ngritjen e funksionimit të shërbimit këshillimor publik në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, si dhe nxit shërbimet digjitale dhe inovacionin në bujqësi, duke bashkëpunuar me universitetet bujqësore;

k) harton e zbaton politikat për marketingun agrar dhe agropërpunues. Përgatit strategji dhe projekte, duke bashkëpunuar edhe me organizma ndërkombëtarë për analizimin e zhvillimit të shkëmbimeve tregtare dhe sidomos për rritjen e eksportit të produkteve shqiptare;

l) harton regjistrin e fermerëve.

4. Vendimi nr. 608, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama